



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/53

Datë: 06.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 06 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 52 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAQI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/53

Datë: 06.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 06 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Punës i Qeverisë së Kosovës për vitin 2009.
2. Për zbatimin e Planit sipas pikës 1 të këtij vendimi ngarkohen Zyra e Kryeministrit, të gjitha ministrinë dhe institucionet tjera të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/53

Datë: 06.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 06 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 343,510.00 Euro për Shoqatën e Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për rregullimin e protezave të anëtarëve të saj.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi, sigurohen nga "Shpenzimet e Paparashikuara" të Qeverisë dhe barten në Ministrinë e Shëndetësisë, Programin "Trajtimi mjekësor jashtë vendit", Kategoria ekonomike "Subvencione dhe Transfere".
3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/53

Datë: 06.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 06 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi Nr. 04/30 i datës 19 gusht 2008.
2. Pika 1 e vendimit Nr. 04/30, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim :
 - 1.1 Ndryshimi i Statusit të Oficerëve të Sigurimit të Policisë së Kosovës në Zyrtarë Policorë brenda policisë së Kosovës, duhet të bëhet në përputhshmëri me procesin e drejt dhe transparent të selektimit, trajnimit dhe procedurave të punësimit në Policinë e Kosovës dhe në pajtim me Ligjin për Policinë.
 - 1.2 Ndryshimi i Statusit të Oficerëve të Sigurimit të Policisë së Kosovës në Zyrtarë Policorë, do të përfshijë mundësinë për t'u bërë Zyrtarë të Policisë apo staf civil brenda policisë së Kosovës, në pajtim me procedurat e pozitës së hapur të punësimit në Policinë e Kosovës.
 - 1.3 Ministria e Punëve të Brendshme mbetet e obliguar të zbatojë këtë vendim në pajtim me Ligjin për Policinë dhe të ndihmojë procesin në bashkëpunim me autoritetet kompetente të Policisë së Kosovës, duke përfshirë edhe proceset tashmë në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë